

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë,

Programi IPA III (2021-2027) ka në portofolin e tij edhe dy fusha shumë të rëndësishme për mjedisin. Mjedisi, tashmë është prioritet jo vetëm i qeverisë shqiptare, por edhe prioritet botëror, sepse, në fakt, është pikëpyetja e madhe mbi të cilën qëndron i gjithë planeti. Dy projekte madhore janë të përfshira në IPA-n III, ekonomia qarkulluese, me në fokus menaxhimin e integruar të mbetjeve, dhe programi i dytë është natyra dhe zonat e mbrojtura. Për programin e parë “Ekonomia qarkulluese” janë parashikuar 35 milionë euro për të forcuar hapat e Shqipërisë në aksionin europian të rritjes së gjelbërt për një Shqipëri të pastër si pjesë e sfidës mbarëbotërore për menaxhimin e integruar të mbetjeve, një betejë, në fakt, që asnjë vend nuk e ka fituar plotësisht sot.

Ama, një pjesë e vendeve më të avancuara europiane, por edhe më të emancipuara, kanë identifikuar modelin, rrugën, se si shoqëria e konsumit duhet të përballojë bashkëjetesën me mbetjet që vetë shoqëria i prodhon. Kjo qeveri, që në javët e para të marrjes së detyrës, bëhemi plot 1 vit, e ka bërë pjesë të përditshmërisë së punës së saj, bashkë me pushtetin vendor, aksionin për pastrimin kombëtar me përforsim disafish të kësaj pune në sezonin veror që sapo kaluam, kur edhe popullsia u shtua me dhjetë herë në disa prej bashkive të bregdetit. Në këtë kontekst, programi IPA III do të zbatojë modele për menaxhimin e integruar të mbetjeve, e kam fjalën për mbetjet e ngurta bashkiake, dhe për mbylljen e vend-depozitimeve të paligjshme në zonat e menaxhimit të mbetjeve për dy qarqe ku do të përqendrohet programi.

Konkretisht, e kam fjalën për qarkun e Kukësit dhe për qarkun e Gjirokastrës. Natyrisht, këto modele që do të ndërtohen falë këtij programi në të dyja qarqet, Kukës dhe Gjirokastrë, do të bazohen në studimin e fizibilitetit, të kryer po nga fondet e Bashkimit Europian për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga përdoruesi, që do të thotë nga prodhuesi i mbetjeve, deri në pikën

fundore të trajtimit të mbetjeve të ngurta, me një theks të veçantë në ndarjen në burim, në riciklimin dhe edukimin mjedisor. Programi do të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe në zhvillimin e ekonomisë qarkulluese në mënyrë gjithëpërfshirëse, por sidomos të përgjegjshme, dhe të rritjes së gjelbërt në Shqipëri.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë përafrimin e legjislacionit, prezantimin sidomos të një ligji që ne po përgatisim ta sjellim së shpejti në Kuvend, që ka të bëjë me përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit, mbështetjen e sektorit privat në ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbërt. Aksioni do të mbështesë transpozimin e direktivave kryesore të planifikimit për pajtueshmërinë ligjore, që është shumë e domosdoshme; për parandalimin e mbetjeve, krijimin e ekonomisë qarkulluese dhe mbetjet e rrezikshme. Për më tepër, po ky program do të mbështesë forcimin e kapaciteteve të autoriteteve të menaxhimit të mbetjeve, si në nivel të njësisive të qeverisjes vendore, ashtu edhe në nivel qendror, për të siguruar mjete, për të zbatuar dhe monitoruar politikatat e menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë këtu edhe ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të integruar për mbledhjen e të dhënave të mbetjeve.

Kjo pjesë do të mbështesë si Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të përmbushur kërkesat e raportimit, ashtu edhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. Aktivitetet synojnë futjen dhe zbatimin e njohurive dhe të praktikave më të mira të shërbimeve të ngjashme në vendet e BE-së, duke përmbushur objektivat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Nuk do të lihet jashtë vëmendjes puna me sjelljen sociale dhe komunitare, që ka të bëjë drejtpërdrejt edhe me ngritjen e shkallës së emancipimit të shoqërisë në mënyrën dhe në mentalitetin që ne kemi apo që nuk e kemi, në raport me sjelljen ndaj menaxhimit të mbetjeve.

Kjo do të ndikojë në mënyrë cilësore në ekonominë në rritje dhe në menaxhimin e rritjes së konsumit, nga njëra anë, të një pjese të madhe të popullsisë dhe, nga ana tjetër, në mënyrën se si popullsia sillet me mbetjet që ky konsum prodhon. Programi tjetër shumë i rëndësishëm, që quhet EU for Nature ose Europa për natyrën, parashikon një fond prej 6 milionë eurosh, që konsiston në mbrojtjen e natyrës, të identifikuar si një nga prioritetet kryesore mjedisore nga qeveria shqiptare për financimin nga IPA III. Ky program është krijuar për të kontribuar në

menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura dhe në krijimin e zonave të reja të mbrojtura si pjesë e përgatitjes për rrjetin “Natyra 2000”.

Objektivi i përgjithshëm i programit është të mbrojë dhe të ruajë objektivin minimal deri në vitin 2030 në 25% të territorit. Jemi tashmë në 21,3%, me vendimet e fundit të qeverisë në janar të këtij viti, dhe për të zbatuar një sistem efektiv të zonave të mbrojtura për të arritur një objektiv maksimal në 35% të territorit të zonave të mbrojtura deri në vitin 2030, për të ruajtur ekosistemet, por edhe për të parandaluar pasojat e tjera që sjellin ndryshimet klimatike, mbi të cilat ndoshta ne nuk ndikojmë dot, por prej të cilave nuk shkëputemi dot. Organizimi institucional dhe kapacitetet e duhura të institucioneve përkatëse, siç është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe organizatat e saj rajonale, janë kyçe për ruajtjen e habitateve dhe specieve të rëndësishme, kapacitete që do të përfshijnë, gjithashtu, burimet e duhura për inspektim, kontroll dhe monitorim.

Ky program do të forcojë kapacitetet e institucioneve përkatëse për të menaxhuar zonat e mbrojtura dhe për të krijuar sisteme efektive në performancë nga qeliza më e fundit deri në qendër. Ai do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të këtyre zonave në bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera, sidomos njësitë e qeverisjes vendore, trupat inspektuese, Policinë e Shtetit, por edhe me gjyqësorin, kur bëhet fjalë për krimin mjedisor. Së fundi, veprimi do të kontribuojë në adresimin ose më saktë në gjetjen e formulave më të shpejta, më të drejtpërdrejta dhe më me efekt në shoqëri për të ngushtuar hendekun që ekziston midis njohurive për shpërndarjen e habitateve dhe specieve në vend. Kjo do të ndikojë, gjithashtu, jo vetëm në edukimin e të rinjve, por edhe në rritjen e emancipimit të shoqërisë për të kuptuar përse zonat e mbrojtura nuk janë thjesht një moment krenarie për një zonë apo për një individ që punon aty, ato janë, në radhë të parë, një arsye, një argument për të zbutur shumë nga problemet që ne kemi dhe me të cilat përballemi si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Dua të them edhe një gjë tjetër. Të dyja këto programe, që kanë të bëjnë me mjedisin dhe që përkojnë, në fakt, me prioritetin e qeverisë, janë ndërtuar në koordinim të plotë me strukturën e re të ndërtuar në këtë mandat, që është Agjencia e Koordinimit të Ndihmës. Falë këtij

koordinimi shumë profesional, e kemi strukturuar të gjithë programin jo vetëm për të caktuar cilat janë prioritetet, çfarë na duhet në këtë vit dhe çfarë na duhet në vitet, për të cilat jemi angazhuar deri në vitin 2030, për atë që ne e kemi quajtur Shqipëria 2030, por edhe për të qartësuar saktësisht dhe për të gjurmuar çdo cent të projekteve, të programeve IPA, ku do të shkojnë, si do të përdoren dhe si do të ndikojë kjo drejtpërdrejt nga komuniteti, për t'i dhënë Çezarit atë që i takon Çezarit.

Ndërkohë, jemi ende në një proces shumë të gjatë që ka të bëjë, në fakt, me prioritetin e mjedisit. Asnjëherë më shumë sesa sot, fjala “mjedis” nuk ka qenë pjesë e ligjërimeve publike në të gjitha nivelet, krahasuar, le të themi, me 10 vjet më parë, që ishte më shumë term që e lexonim, por nuk e dëgjonim dhe, sidomos, nuk e përdornim. Megjithatë, kjo tregon, në fakt, se sa më shumë të flasim, sa më shumë të debatohet për mjedisin, edhe ritmi i emancipimit të shoqërisë ecën përpara, por nuk mjafton. Nuk mjafton, sepse jemi ende shumë larg ndërtimit dhe krijimit të një ndërgjegjeje gjithëpërfshirëse sociale me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin, duke mos e konsideruar si diçka abstrakte, por si diçka të përditshme të jetës sonë.

Kjo kërkon, në fakt, bashkim forcash, kërkon bashkim mjetesh, por sidomos kërkon bashkimin e të gjithë aktorëve duke e konsideruar si një kauzë kombëtare. Nuk kemi kauzë kombëtare më të rëndësishme sesa mjedisin, natyrën, sepse ajo prek shëndetin dhe të ardhmen e fëmijëve tanë. Prandaj, nuk besoj se kemi arsye të mos e votojmë këtë program që ka edhe mjedisin, edhe natyrën brenda. Faleminderit!